



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: “Zhan D’Ark” Nr.2

Tiranë, Shqipëri

[Tel/Fax:+355 4 2380 300/315](tel:+35542380300315)

[E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)

www.avokatipopullit.gov.al

Nr.

Prot.

Tiranë ___/___/2020

Lënda: *Për të mos lënë asnjë individ/familje pa përfituar ndihmën ekonomike, me qëllim minimizimin e ndikimit social dhe ekonomik të pandemisë në komunitet.*

Drejtuar: **Bashkisë Tiranë**
Bashkisë Belsh
Bashkisë Berat
Bashkisë Bulqizë
Bashkisë Cërrik
Bashkisë Delvinë
Bashkisë Devoll
Bashkisë Dibër
Bashkisë Divjakë
Bashkisë Dropull
Bashkisë Durrës
Bashkisë Elbasan
Bashkisë Fier
Bashkisë Finiq
Bashkisë Fushë-Arrëz
Bashkisë Gjirokastrë
Bashkisë Gramsh
Bashkisë Has
Bashkisë Himarë

Bashkisë Kamëz
Bashksë Kavajë
Bashkisë Klos
Bashkisë Kolonjë
Bashkisë Konispol
Bashkisë Korçë
Bashkië Krujë
Bashkisë Kukës
Bashkisë Kurbin
Bashkisë Kuçovë
Bashkisë Këlcyrë
Bashkisë Lezhë
Bashkisë Libohovë
Bashkisë Librazhd
Bashkisë Lushnje
Bashksë Maliq
Bashkisë Mallakastër
Bashkisë Malësi e Madhe
Bashkisë Mat
Bashkisë Memaliaj
Bashkisë Mirditë
Bashkisë Patos
Bashkisë Peqin
Bashkisë Pogradec
Bashkisë Poliçan
Bashkisë Prrenjas
Bashkisë Pukë
Bashkisë Pustec
Bashkisë Përmet
Bashkisë Roskovec
Bashkisë Rrogozhinë
Bashkisë Sarandë
Bashkisë Selenicë

Bashkisë Shijak
Bashkisë Shkodër
Bashkisë Skrapar
Bashkisë Tepelenë
Bashkisë Tropojë
Bashkisë Ura Vajgurore
Bashkisë Vau i Dejës
Bashkisë Vlorë
Bashkia Vorë

Të nderuar,

Avokati i Popullit si një institucion i pavarur, i parashikuar shprehimisht në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, është një garanci kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, shtetas shqiptarë, të huaj, rezident të rregullt, ose jo në Shqipëri, refugjatë, si dhe të personave pa shtetësi, që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj.

Mbrojtja dhe garantimi i të drejtave të grupeve në nevojë, ka qenë dhe vijon të jetë, një ndër prioritetet e punës së këtij institucioni. Një numër i konsiderueshëm familjesh shqiptare jetojnë në kushte tejet të vështira ekonomike, pa të ardhura financiare.

Institucioni i Avokatit të Popullit është duke monitoruar me shumë vëmendje, masat e marra nga autoritetet shqiptare për kategoritë më të rrezikuara në këtë periudhë të përhapjes globale të virusit Covid-19, me qëllim garantimin e jetesës normale në kushtet e izolimit. Mbështetja për të sigurimin e të drejtave të njeriut, së bashku me mbrojtjen e anëtarëve më të prekshëm të komuniteteve tona nga një kërcënim ekzistencial është një qëllim legjitim. Distancimi shoqëror dhe vetë-izolimi, janë një sfidë për të gjithë ne, por janë të nevojshme për jetën dhe shëndetin e çdo anëtari të shoqërisë sonë.

Tashmë është e ditur botërisht, që ka mjaft shtresa të marginalizuara dhe që ndeshen me vështirësi për marrje informacionesh dhe shërbimesh publike, për mjaft arsye, ndaj në përgjigjen mbi masat kundër COVID-19, kujdes i veçantë duhet për të identifikuar edhe njerëzit e prekur nga varfëria ekstreme. Kjo kërkon vënie në dispozicion të informacioneve në formate dhe gjuhë të kuptueshme për këtë shtresa të popullsisë, por edhe qasjen ndaj personave me probleme të dëgjimit, shikimit, pra arritjen e informacionit tek këta persona me aftësi të kufizuara, të cilët mund të mos e kenë as qasjen në internet. Qasja e tyre në internet është thelbësore, pasi në këtë mënyrë i sigurohet atyre informacioni pa u prekur nga virusi. Kjo pandemi po kërcënon jetë njerëzsh dhe mjete jetese, kufijtë janë mbyllur dhe familjet përpiqen të mbijetojnë, ndaj sfidë mbetet arritja e ndihmës në komunitetet më të cënueshme.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.254 datë 27.03.2020 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, ndihmës ekonomike e të pagesës të së ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore të shpallur si pasojë e COVID-19”, ka përcaktuar se një nga kategoritë që përfitojnë dyfishin e pagesës, janë individët që përfitojnë ndihmë ekonomike.

Sipas pikës 2, në Kreun IV të këtij vendimi, pagesa e ndihmës ekonomike për subjektet përfituese, që rezultojnë përfitues të ndihmës ekonomike ose kanë aplikuar për të përpara datës 10 Mars 2020, do të jetë sa dyfishi i shumës së llogaritur sipas VKM nr. 597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.

Në Urdhrin nr.213 datë 31/03/2020 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për marrjen e masave për parandalimin e infektimit nga Covid-19 të aplikuesve për Ndihmë ekonomike”, aplikimet për ndihmën ekonomike do të pranohen nga administratorët shoqërorë të njësive administrative në formë elektronike ose postare, dhe pagesa e ndihmës ekonomike do të vijojë pa ndërprerje.

Pra, që nga data 01.04.2020, të gjithë familjet dhe individët që përfitojnë ndihmën ekonomike do të përfitojnë pagesën e ndihmës ekonomike pa pasur nevojë që ata të paraqiten për të kryer aplikimin për përfitimin e kësaj pagese.

Në këtë proces administratorët shoqërorë të njësive administrative janë përgjegjës për kryerjen e aplikimeve për ndihmë ekonomike, duke mundësuar ata vetë kontaktin elektronik ose me telefon, për t’iu ardhur në ndihmë të gjithë aplikuesve për përfitimin e ndihmës ekonomike.

Pavarësisht se formulari përkatës, që duhet të plotësohet për përfitimin e ndihmës ekonomike është online, duhet theksuar fakti se jo të gjithë individët mund të kenë akses për të bërë këtë aplikim. Shumë familje nuk kanë asnjë mundësi për të aplikuar, pasi nuk kanë në përdorim mjete elektronike apo dhe mjete komunikimi, veçanërisht ato që jetojnë në zona të thella.

Varfëria nuk është vetëm mungesë e të ardhurave; por edhe mungesë shërbimesh dhe pjesëmarrjeje në shoqëri, të cilat janë thelbësore për gëzimin e të drejtave të njeriut. Varfëria si shkak, por edhe si pasojë e shkeljeve të të drejtave të njeriut, duhet të adresohet në kontekstin e detyrimeve të shtetit për respektimin e garantimin e të drejtave të njeriut. Një qasje e bazuar në të drejtat e njeriut, do të thotë që standardet dhe parimet e të drejtave të njeriut të jenë në thelbin e planifikimit dhe politikave shtetërore.

Dimensionet njerëzore të pandemisë COVID-19 shkojnë përtej krizës kritike shëndetësore. Të gjithë aspektet e të ardhmes sonë do të preken, ndaj përgjigja jonë duhet të jetë urgjente, dhe e koordinuar, duhet të ofrojë ndihmë të menjëherëshme për ata që kanë më shumë nevojë. Prandaj, të gjithë së bashku duke bashkëpunuar, bashkërenduar dhe koordinuar punën, me qëllim evidentimin e problematikave dhe zgjidhjen e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi, të përpiqemi, t’a përballojmë me sukses situatën e pandemisë, mbështetur në respektimin tërësor të të drejtave të njeriut në Shqipëri. Ofrimi i ndihmës konkrete dhe i mjeteve bazë të jetesës, për të përballuar dhe kapërcyer sa më denjësisht këtë situatë, kërkon një vlerësim objektiv dhe të menjëhershëm si dhe garantim të shërbimeve bazë sociale në nivelin e qeverisjes vendore.

Ndaj Avokati i Popullit, duke përshëndetur punën e deritanishme të pushtetit vendor për t'iu ardhur në ndihmë familjeve në nevojë, në këtë periudhë pandemie, sugjeron si kërkesë tepër të nevojshme:

- vijimin pa ndërprerje të dhënies së pagesës së ndihmës ekonomike, pasi kjo pagesë, është e vetmja burim jetese për këto familje.
- nga ana e administratorëve shoqërorë, të bëhet evidentimi i atyre familjeve në nevojë, të cilat nuk kanë asnjë mundësi për aplikimin online të ndihmës ekonomike dhe ndihmën në kryerjen e plotësimit të aplikimit, me qëllim përfitimin e pagesës së ndihmës ekonomike.

Sa më sipër, lutemi kthimin e një përgjigjeje për masat e marra në mundësinë tuaj të parë.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit midis institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes të të drejtave të njeriut.

K O M I S I O N E R

Vilma SHURDHA